REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njësia Org. / Org. Jedin / Org Unit: 9/3
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 1
Nr. Prot. / Br. Prot / Prot.No: 3702
Data: / Datum: / Date: 31.07.25
PRISHTINË/A NO.1

MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI SH.A
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D
MITROVICA
TEL/FAX: 020/233-797, 520-304
Nr. 01-939/2
Data: 31.07.2025

# Raporti i Performancës për Tremujorin e Dytë (TM2) për vitin 2025

**Bordi i Drejtorëve**, në mbledhjen e rregullt nr. 06-2025, të mbajtur më datat 29.07.2025 dhe 31.07.2025, miratoi **Raportin e Performancës për Tremujorin e Dytë (TM2) të vitit 2025**.

| | Delegoi | Aprovoi |
|---|---|---|
| Emri Mbiemri | Kryeshef Ekzekutiv: Bashkim Kurti | Kryesuese e BtD-së: Kumrije Kelmendi Aliu |
| Nënshkrimi | | |
| Data | 31.07.25 | 31/07/2025 |

KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI SH.A REGIONAL WATER COMPANY J.S.C KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D MITROVICA

*KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI "MITROVICA" SH. A.*

# *RAPORT PERIODIK I PERFORMANCËS TM2- 2025*

*Korrik, 2025*

*Përmbajtja*

*1. HYRJE* 5

*1.1 Performanca e kompanisë dhe integrimi i komunave veriore* 5

1.2 Përmbledhje e treguesve kryesorë TM2 2024 / TM2 2025 5

*2. SHËRBIMI ADMINISTRATIV* 7

2.2 Zyra Ligjore 8

2.2.1 Punët përmbarimore 8

*3. SHËRBIMI FINANCIAR* 11

3.1 Raporti Operativo – financiar 11

3.2 Realizimi i Planit të Biznesit 17

*4. SHËRBIMI KOMERCIAL* 19

4.1 Përmbledhje 19

*5. SHËRBIMI TEKNIK* 24

5.1 Distribuimi 24

5.2 Kualiteti i ujit 25

*5.3 Kemikatet* 25

*5.4 ITUN në Skenderaj* 26

*5.5 Raport i Njësive Operative* 26

*5.6 Sektori i mirëmbajtjes së automjeteve* 26

5.6 Planifikimit & Zhvillimit 27

5.7 Punimet dhe Zhvillimet për Pjesë Veriore 29

*6. IMPIANTI PËR TRAJTIMIN E UJRAVE TË ZEZA – PROJEKTI* 32

6.1 Aktivitetet e Përfunduara dhe Statusi Aktual i Projektit për Zhvillimin e Ujërave të Ndotura në Mitrovicë 32

6.2 Statusi aktual 32

*7. ZYRA PËR INFORMIM RAPORTIM DHE MARDHËNIE ME PUBLIKUN* 34

7.1 Zyra për Informim, Raportim dhe Marrëdhënie me Publikun 34

7.3 Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit 34

7.4 Përmbledhje e Prononcimit në Media të Kryeshefit Ekzekutiv 35

7.5 Intervista ne RTK 35

7.6 Video mesazhi i Kryeshefit Ekzekutiv _____ 36

7.7 Video mesazhi i Kryeministrit të Kosovë z. Albin Kurti _____ 36

*8. PROKURIMI* _____ *37*

## *Lista e tabelave*

Tabela 1. Punët e kryera nga Sekretaria për Bordin e Drejtorëve për periudhën TM2 2025 ..... 7

Tabela 2. Lista e Aktiviteteve ..... 8

Tabela 3. Pasqyra e Aktiviteteve Përmbarimore sipas Përmbaruesit Privat ..... 8

Tabela 4. Përmbaruesi Privat – Ilmi Miftari ..... 9

Tabela 5. Përmbaruesi Privat – Atip Mustafa ..... 9

Tabela 6. Përmbaruesi Privat Fazli Gjonbalaj ..... 9

Tabela 7. Kallëzime Penale ..... 10

Tabela 8. Struktura e përgatitjes profesionale të punonjësve ..... 10

Tabela 9.Statistika; Profesionale dhe gjinore e KRUM sipas njësive ..... 10

Tabela 10. Indikatorët kryesorë të Njësisë Operative - Mitrovicë ..... 11

Tabela 11. Indikatorët kryesorë të Njësisë Operative – Vushtrri ..... 12

Tabela 12. Indikatorët kryesorë të Njësisë Operative – Skënderaj ..... 13

Tabela 13. Indikatorët kryesorë të KRUM – Pa Veri dhe Zveçan ..... 14

Tabela 14. Indikatorët kryesorë të KRUM – Mitrovicë veriore dhe Zveçan ..... 15

Tabela 15. Indikatorët kryesorë të KRUM – Mitrovica sh.a Total ..... 15

Tabela 16. Krahasimi TM2-2025 me TM2-2024 KRUM – Mitrovica sh.a Total ..... 16

Tabela 17. Realizimi i planit të biznesit Faturimi m3 ..... 17

Tabela 18.Realizimi i planit të biznesit Faturimi në Euro. ..... 17

Tabela 19.Realizimi i planit të biznesit Inkasimi ..... 18

Tabela 20. Krahasimi i Inkasimit&Faturimit për TM2 2024/TM2 2025 ..... 20

Tabela 21. Inkasimi & Numri i Konsumatorëve dhe Mesatarja e Inkasimit për Konsumator ..... 20

Tabela 22. Kontratat e Shërbimit dhe Riprogramimit - Krahasimi ..... 21

Tabela 23. Kontrata riprogramimi për 1000 konsumatorë ..... 22

Tabela 24. Numri i Pagesave – Krahasimi ..... 22

Tabela 25. Verifikimet dhe Montimet e Ujëmatësve ..... 23

Tabela 26. Ankesat dhe Kërkesat e Konsumatorëve (CRM) ..... 23

Tabela 27. Distribuimi i ujit nga ITU ..... 24

Tabela 28. Krahasimi i furnizimit nga ITU 2025 dhe 2024 ..... 24

Tabela 29. Sasia e kemikateve të përdorura TM ..... 25

Tabela 30 Furinizimi me ujë sipas njësive operative ..... 26

Tabela 31. Parametrat e mirëmbajtjeve të rrjetit të ujit dhe kanalizimit TM2 ..... 27

Tabela 32. Të dhënat e inkorporuara në GIS ..... 28

Tabela 33. Kërkesat/Ankesat ..... 28

**Tabela 34. Sasia e ujit e shpërndar nga ITU Zubin Potok** ..... 30

Tabela 35. Sasia e kemikateve të përdorura ..... 30

Tabela 36. Intervenimet teknike në rrjetin e ujit ..... 30

Tabela 37. Aktivitetet e Prokurimit ..... 37

# 1. HYRJE

## 1.1 Performanca e kompanisë dhe integrimi i komunave veriore

**Tremujori i dytë i vitit 2025** shënon një moment kyç në historikun operativ të kompanisë, pasi më 13.05.2025 ka filluar zyrtarisht marrja në menaxhim e komunave Mitrovicë e Veriut, Zveçan dhe Zubin Potok. Ky zgjerim ka paraqitur sfida të konsiderueshme në aspektin e burimeve njerëzore, logjistikës teknike dhe kapaciteteve financiare.

Megjithatë, pavarësisht këtyre sfidave, kompania ka arritur të vendosë një funksionim të qëndrueshëm dhe efikas në këto njësi të reja, duke rritur standardet e ofrimit të shërbimeve dhe përmirësuar treguesit e performancës në nivel të përgjithshëm. Ky progres dëshmon angazhimin e lartë institucional dhe vullnetin e fortë për përmbushjen e misionit në të gjithë zonën e mbulimit.

## 1.2 Përmbledhje e treguesve kryesorë TM2 2024 / TM2 2025

**Raporti periodik për TM2 2025**, në krahasim me TM2 2024, pasqyron zhvillime të rëndësishme në të gjithë treguesit kryesorë të performancës:

- **Prodhimi i ujit** ka shënuar një rënie të lehtë prej 2%, nga 6,991,572 m³ në 6,861,623 m³.
- **Faturimi në vëllim (m³)** është rritur me 12%, ndërsa **faturimi në vlerë monetare pa TVSH** është rritur me 19%, duke reflektuar efikasitet më të lartë në procesin e faturimit.
- **Të hyrat totale me TVSH** janë rritur nga 1,350,688 € në 1,655,094 €, që paraqet një rritje prej 18%.
- **Inkasimi total** është përmirësuar me 14%, nga 1,106,309 € në 1,283,232 €.
- **Numri i konsumatorëve** është rritur me 6%, nga 51,129 në 54,634 konsumatorë.
- **Shpenzimet totale** kanë shënuar një rënie të lehtë prej 1%, si rezultat i menaxhimit të suksesshëm të kostove në disa kategori, si energjia elektrike dhe kimikalet. *(Theksohet se kompania ende nuk ka pranuar faturën e energjisë për muajin qershor nga KEK Sh.A., pasi ka kaluar në tregun e hapur të energjisë.)*
- **Pagat** janë rritur me 3%, duke reflektuar ndryshimin e shumës së shujtës nga 4 € në 5 € që nga fillimi i vitit.

- **Humbjet e ujit** kanë pësuar një përmirësim të ndjeshëm, duke rënë nga 55% në vitin 2024 në 48% në vitin 2025. Në këtë ulje ka ndikuar menaxhimi më i mirë i impianteve të ujit dhe reduktimi i humbjeve komerciale.

Kompania vazhdon të shënojë një trend pozitiv dhe të qëndrueshëm të përmirësimit nga viti në vit. Krahasimi me TM2 2024 tregon qartë progres në kontrollin operativ dhe reduktimin e ujit të humbur. Këto rezultate dëshmojnë përparimin e vazhdueshëm në aspektin komercial dhe financiar, pavarësisht sfidave me të cilat përballet kompania.

## 2. SHËRBIMI ADMINISTRATIV

Gjatë tremujorit të dytë, **Departamenti i Administratës** ka përgatitur raporte dhe informata nga veprimtaria e shërbimit juridik, në përputhje me detyrat dhe obligimet e punës të përcaktuara për këtë departament.

Po ashtu, ky departament ka pranuar dhe arkivuar dokumente të ardhura si nga jashtë, ashtu edhe nga brenda kompanisë, duke i sistemuar me saktësi nëpër departamentet dhe arkivat përkatëse të KRUM-it.

***Tabela 1. Punët e kryera nga Sekretaria për Bordin e Drejtorëve për periudhën TM2 2025***

| | Bordi Drejtorëve | Komisioni i Auditimit |
|---|---|---|
| **Mbledhjet** | 3 | 2 |
| **Agjendat** | 3 | 2 |
| **Procesverbalet finale** | 3 | 2 |
| **Vendimet e Bordit** | 2 | 0 |

### *2.1 Burimet Njerzore*

Gjatë tremujorit të dytë, **Departamenti i Burimeve Njerëzore** ka realizuar një sërë aktivitetesh dhe procesesh administrative kyçe në fushën e marrëdhënieve të punës. Në këtë periudhë janë zhvilluar procedurat e shpalljes së konkurseve dhe rekrutimit të punonjësve, duke përfshirë edhe fazën e nënshkrimit të kontratave të punës.

Pas aprovimit nga Bordi të shpalljes së pozitave të nevojshme për stafin në veri, departamenti ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm në kuadër të procesit të rekrutimit, me synim sigurimin e kapaciteteve të domosdoshme për ofrimin efikas të shërbimeve institucionale dhe forcimin e pranisë administrative në atë zonë.

Përveç këtyre aktiviteteve, janë realizuar edhe procese të tjera administrative, përfshirë menaxhimin e dokumentacionit të punonjësve dhe përditësimin e regjistrave të brendshëm, gjithmonë në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, si dhe me standardet dhe politikat e brendshme të organizatës.

*Tabela 2. Lista e Aktiviteteve*

| Nr. | *Lista e aktiviteteve, veprimeve dhe vendimeve të cilat janë përpiluar, përfunduar/ ekzekutuar gjatë periudhës TM2 2025* | |
|---|---|---|
| 1 | Përpilimi i vendimeve për formim të komisioneve | |
| 2 | Përpilimin e të gjitha llojeve të aktvendimeve të ndryshme përfshirë, autorizime, urdhëresa dhe vërtetime , nga fusha e marrëdhënies së punës , përgatitja dhe ekzekutimi i pagave , përditësimi i të dhënave të punëtorëve, publikimi i konkurseve, raporte të ndryshme për nevoja të kompanisë , përpunimi i të dhënave për ditët e shfrytëzuara të pushimit vjetor/mjekësor etj. | |

## 2.2 Zyra Ligjore

### 2.2.1 Punët përmbarimore

*Tabela 3. Pasqyra e Aktiviteteve Përmbarimore sipas Përmbaruesit Privat*

| Raporti TM-2 Prill-Qershor | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Përshkrimi** | **Prill** | **Maj** | **Qershor** | **Totali** |
| **Pagesë Borxhi ne Kompani** | € 3,086.50 | € 2,390.65 | € 1,336.15 | € 6,813.30 |
| **Borxhi I falur Si Borxh I Vjetër** | € 27,902.13 | € 19,636.38 | € 12,419.19 | € 59,958.42 |
| **Pagese e Ujit te Përmbaruesi** | € 3,680.78 | € 19,130.25 | € 5,807.33 | € 28,618.36 |
| **Kthimi I Shpenzimeve nga Përmbaruesi** | € 786.06 | € 1,377.86 | € 688.97 | € 2,852.89 |
| **Lirim Nga TVSH 8%** | € 2,066.82 | € 1,454.54 | € 853.32 | € 4,374.68 |
| **Pagesat nga Kontratat ne Kompani** | € 6,986.00 | € 1,723.00 | € 5,162.50 | € 13,871.50 |
| **Marrëveshje nga Kontratat ne Kompani** | € 69,507.44 | € 23,160.03 | € 23,509.56 | € 116,177.03 |
| **Gjithsej:** | € 114,015 | € 68,872.71 | € 49,777.02 | € 232,666.18 |

### *Tabela 4. Përmbaruesi Privat – Ilmi Miftari*

| Përmbarues Privat - Ilmi Miftari | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Muajt | Prill | Maj | Qershor | Totali |
| Propozime | 56 | - | - | 56 |
| Përgjigje Prapsim | 3 | 6 | 3 | 12 |
| Ekzekutime /Lëndë te Përfunduara | 7 | 10 | 7 | 24 |
| Kontrata/ Marrëveshje | 2 | 27 | 2 | 35 |
| Vlera e Realizuar | 1,348 | 2,597 | 1,435 | 5,380 |
| Kthim Takse | 466 | 709 | 163 | 1,339 |

### *Tabela 5. Përmbaruesi Privat – Atip Mustafa*

| Përmbaruesi Privat - Atip Mustafa | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Muajt | Prill | Maj | Qershor | Totali |
| Propozime | 56 | - | - | 56 |
| Përgjigje Prapsim | 7 | 23 | 3 | 33 |
| Ekzekutime /Lëndë te Përfunduara | 8 | 13 | 13 | 34 |
| Kontrata/ Marrëveshje | 22 | 30 | 47 | 99 |
| Vlera e Realizuar | 987 | 14,823 | 3,587 | 19,398 |
| Kthim Takse | 269 | 538 | 482 | 1,290 |

### *Tabela 6. Përmbaruesi Privat Fazli Gjonbalaj*

| **Përmbaruesi Privat - Fazli Gjonbalaj** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Muajt** | Prill | Maj | Qershor | Totali |
| **Propozime** | 55 | - | - | 55 |
| **Përgjigje Prapsim** | - | 4 | 3 | 7 |
| **Ekzekutime /Lëndë te Përfunduar** | 2 | 3 | 1 | 6 |
| **Kontrata/ Marrëveshje** | 15 | 1 | 18 | 33 |
| **Vlera e Realizuar** | 1,346 | 1,710 | 785 | 3,841 |
| **Kthim Takse** | 51 | 130 | 41 | 222 |

### *Tabela 7. Kallëzime Penale*

| | |
|---|---|
| Kallëzime Penale | 39 |
| Vlera e dëmit | € 32,599 |
| Pagesa | €32,638 |
| Kontrata | €1,409 |

### *Tabela 8. Struktura e përgatitjes profesionale të punonjësve*

| Përgatitja profesionale | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Struktura | Master | | Baçelor | | E mesme/e lartë | | Shkolla Fillore | | Pakualifikuar | | Gjithsej: | | Totali : |
| Nacionale | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M/F |
| Shqiptar | 16 | 7 | 24 | 13 | 165 | 11 | 13 | 1 | 8 | | 226 | 32 | 258 |
| Boshnjak | | | | | | | 1 | | | | 1 | | 1 |
| Ashkali | | | | | | | | | 1 | | 1 | | 1 |
| Gjithësej: | 16 | 7 | 24 | 13 | 165 | 11 | 14 | 1 | 9 | | 228 | 32 | 260 |

### *Tabela 9.Statistika; Profesionale dhe gjinore e KRUM sipas njësive*

| Përgatitjet Profesionale të Punonjësve | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2025 | Master | | Baçelor | | E mesme/e lartë | | Shkolla Fillore | | Pa kualifikuar | | Gjithsej: | | Totali |
| Njësit | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | |
| Mitrovicë | 13 | 6 | 14 | 11 | 92 | 8 | 4 | | 4 | | 127 | 25 | 152 |
| Vushtrri | 2 | | 7 | 2 | 47 | 2 | 8 | 1 | 2 | | 66 | 5 | 71 |
| Skenderaj | 1 | 1 | 3 | | 26 | 1 | 2 | | 3 | | 35 | 2 | 37 |
| Gjithsej: | 16 | 7 | 24 | 13 | 165 | 11 | 14 | 1 | 9 | | 228 | 32 | 260 |

# 3. SHËRBIMI FINANCIAR

## 3.1 Raporti Operativo – financiar

*Tabela 10. Indikatorët kryesorë të Njësisë Operative - Mitrovicë*

| TREGUESIT | TM1-2025 | TM2-2025 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi m3 | 2,859,610 | 2,798,513 | (61,097) | -2% |
| Faturimi m3 | 906,520 | 1,018,595 | 112,075 | 11% |
| Faturimi nga uji € | 559,093 | 627,944 | 68,850 | 11% |
| Faturimi- te tjera € | 7,669 | 5,654 | (2,015) | -36% |
| Faturimi Total pa TVSH€ | **566,762** | 633,597 | 66,835 | 11% |
| Faturimi total me TVSH | **612,870** | **684,851** | 71,981 | 11% |
| Inkasimi nga uji € | 524,636 | 610,758 | 86,122 | 14% |
| Inkasimi - te tjera € | 8,520 | 5,204 | (3,316) | -64% |
| Inkasimi Total € | **533,155** | 615,961 | 82,806 | 13% |
| Nr. i Konsumatorëve | 24,133 | 24,297 | 164 | 1% |
| % e inkasimit | 87% | 90% | | 3% |
| Shpenzimet | **616,375** | 596,033 | (20,342) | -3% |
| Pagat | 347,235 | 342,980 | (4,255) | -1% |
| Rryma elektrike | 125,959 | 99,705 | (26,254) | -26% |
| Shpe. e derivateve | 4,062 | 4,172 | 110 | 3% |
| Miremb. Dhe riparimet | 13,049 | 12,998 | (51) | 0% |
| Kemikalet | 7,780 | 10,118 | 2,338 | 23% |
| Shp. - Iber Lepenci | 84,874 | 85,059 | 185 | 0% |
| Shpenzimet tjera | 33,416 | 41,001 | 7,585 | 18% |
| Uji I pafaturuar në m3 | **1,953,090** | 1,779,918 | (173,172) | -10% |
| Uji I pafaturuar ne % | 68% | 64% | | -5% |
| Mbulimi operativ | **86%** | **103%** | | 17% |

*Tabela 11. Indikatorët kryesorë të Njësisë Operative – Vushtrri*

| TREGUESIT | TM1-2025 | TM2-2025 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi m3 | 1,744,699 | 1,928,915 | 184,216 | 10% |
| Faturimi m3 | 763,815 | 887,897 | 124,082 | 14% |
| Faturimi nga uji € | 422,429 | 490,189 | 67,759 | 14% |
| Faturimi- te tjera € | - | 126 | 126 | 100% |
| Faturimi Total pa TVSH€ | 422,429 | 490,315 | 67,886 | 14% |
| Faturimi total me TVSH | 456,224 | 529,553 | 73,329 | 14% |
| Inkasimi nga uji € | 420,016 | 481,589 | 61,574 | 13% |
| Inkasimi - te tjera € | - | - | - | |
| Inkasimi Total € | 420,016 | 481,589 | 61,574 | 13% |
| Nr. i Konsumatorëve | 19,651 | 20,520 | 869 | 4% |
| % e inkasimit | 92% | 91% | | -1% |
| Shpenzimet | 298,040 | 293,535 | (4,505) | -2% |
| Pagat | 183,132 | 181,795 | (1,337) | -1% |
| Rryma elektrike | 51,618 | 36,691 | (14,927) | -41% |
| Shpe. e derivateve | 1,800 | 2,824 | 1,024 | 36% |
| Miremb. Dhe riparimet | 1,247 | 3,548 | 2,301 | 65% |
| Kemikalet | 4,106 | 3,813 | (293) | -8% |
| Shp. - Iber Lepenci | 37,306 | 39,173 | 1,867 | 5% |
| Shpenzimet tjera | 18,831 | 25,691 | 6,860 | 27% |
| Uji I pafaturuar në m3 | 980,884 | 1,041,018 | 60,134 | 6% |
| Uji I pafaturuar ne % | 56% | 54% | | -2% |
| Mbulimi operativ | 141% | 164% | | 23% |

### *Tabela 12. Indikatorët kryesorë të Njësisë Operative – Skënderaj*

| TREGUESIT | TM1-2025 | TM2-2025 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi m3 | 612,200 | 725,308 | 113,108 | 16% |
| Faturimi m3 | 225,933 | 253,606 | 27,673 | 11% |
| Faturimi nga uji € | 142,635 | 166,698 | 24,063 | 14% |
| Faturimi- te tjera € | 1,910 | 1,659 | (251) | -15% |
| Faturimi Total pa TVSH€ | 144,545 | 168,358 | 23,813 | 14% |
| Faturimi total me TVSH | 156,300 | 181,992 | 25,692 | 14% |
| Inkasimi nga uji € | 153,943 | 184,836 | 30,893 | 17% |
| Inkasimi - te tjera € | 3,253 | 845 | (2,408) | -285% |
| Inkasimi Total € | 157,196 | 185,682 | 28,485 | 15% |
| Nr. i Konsumatorëve | 9,645 | 9,817 | 172 | 2% |
| % e inkasimit | 101% | 102% | | 1% |
| Shpenzimet | 170,900 | 161,443 | (9,457) | -6% |
| Pagat | 120,605 | 112,555 | (8,051) | -7% |
| Rryma elektrike | 23,774 | 16,914 | (6,860) | -41% |
| Shpe. e derivateve | 1,218 | 1,204 | (14) | -1% |
| Miremb. Dhe riparimet | 1,220 | 2,846 | 1,626 | 57% |
| Kemikalet | 1,373 | 1,786 | 413 | 23% |
| Shp. - Iber Lepenci | 14,977 | 15,011 | 34 | 0% |
| Shpenzimet tjera | 7,733 | 11,127 | 3,394 | 31% |
| Uji I pafaturuar në m3 | 386,267 | 471,702 | 85,435 | 18% |
| Uji I pafaturuar ne % | 63% | 65% | | 2% |
| Mbulimi operativ | 92% | 115% | | 23% |

*Tabela 13. Indikatorët kryesorë të KRUM – Pa Veri dhe Zveçan*

| TREGUESIT | TM1-2025 | TM2-2025 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi m3 | 5,216,509 | 5,452,736 | 236,227 | 4% |
| Faturimi m3 | 1,896,268 | 2,160,099 | 263,831 | 12% |
| Faturimi nga uji € | 1,124,158 | 1,284,831 | 160,673 | 13% |
| Faturimi- te tjera € | 9,579 | 7,440 | (2,139) | -29% |
| Faturimi Total pa TVSH€ | 1,133,737 | 1,292,270 | 158,534 | 12% |
| Faturimi total me TVSH | 1,225,393 | 1,396,396 | 171,003 | 12% |
| Inkasimi nga uji € | 1,098,594 | 1,277,183 | 178,589 | 14% |
| Inkasimi - te tjera € | 11,773 | 6,049 | (5,724) | -95% |
| Inkasimi Total € | 1,110,367 | 1,283,232 | 172,865 | 13% |
| Nr. i Konsumatorëve | 53,429 | 54,634 | 1,205 | 2% |
| % e inkasimit | 91% | 92% | | 1% |
| Shpenzimet | 1,085,315 | 1,051,011 | (34,304) | -3% |
| Pagat | 650,972 | 637,330 | (13,642) | -2% |
| Rryma elektrike | 201,351 | 153,310 | (48,041) | -31% |
| Shpe. e derivateve | 7,081 | 8,200 | 1,119 | 14% |
| Miremb. Dhe riparimet | 15,516 | 19,392 | 3,876 | 20% |
| Kemikalet | 13,258 | 15,717 | 2,459 | 16% |
| Shp. - Iber Lepenci | 137,157 | 139,243 | 2,086 | 1% |
| Shpenzimet tjera | 59,980 | 77,819 | 17,839 | 23% |
| Uji I pafaturuar në m3 | 3,320,241 | 3,292,637 | (27,604) | -1% |
| Uji I pafaturuar ne % | 64% | 60% | | -3% |
| Mbulimi operativ | 102% | 122% | | 20% |

### *Tabela 14. Indikatorët kryesorë të KRUM – Mitrovicë veriore dhe Zveçan*

| TREGUESIT | TM1-2025 | TM2-2025 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi m3 | 1,358,393 | 1,408,887 | 50,494 | 4% |
| Faturimi m3 | 1,385,393 | 1,408,887 | 23,494 | 2% |
| Faturimi nga uji € | 230,951 | 239,535 | 8,584 | 4% |
| Faturimi Total pa TVSH€ | 230,951 | 239,535 | 8,584 | 4% |
| Faturimi total me TVSH | 249,427 | 258,698 | 9,271 | 4% |
| Nr. i Konsumatorëve | 4 | 4 | - | 0% |

### *Tabela 15. Indikatorët kryesorë të KRUM – Mitrovica sh.a Total*

| TREGUESIT | TM1-2025 | TM2-2025 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi m3 | 6,574,902 | 6,861,623 | 286,721 | 4% |
| Faturimi m3 | 3,281,661 | 3,568,986 | 287,325 | 8% |
| Faturimi nga uji € | 1,355,109 | 1,524,366 | 169,257 | 11% |
| Faturimi- te tjera € | 9,579 | 7,440 | (2,139) | -29% |
| Faturimi Total pa TVSH€ | 1,364,687 | 1,531,805 | 167,118 | 11% |
| Faturimi total me TVSH | 1,474,820 | 1,655,094 | 180,273 | 11% |
| Inkasimi nga uji € | 1,098,594 | 1,277,183 | 178,589 | 14% |
| Inkasimi - te tjera € | 11,773 | 6,049 | (5,724) | -95% |
| Inkasimi Total € | 1,110,367 | 1,283,232 | 172,865 | 13% |
| Nr. i Konsumatorëve | 53,429 | 54,634 | 1,205 | 2% |
| % e inkasimit | 75% | 78% | 0 | 2% |
| Shpenzimet | 1,085,315 | 1,051,011 | (34,304) | -3% |
| Pagat | 650,972 | 637,330 | (13,642) | -2% |
| Rryma elektrike | 201,351 | 153,310 | (48,041) | -31% |
| Shpe. e derivateve | 7,081 | 8,200 | 1,119 | 14% |
| Miremb. Dhe riparimet | 15,516 | 19,392 | 3,876 | 20% |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kemikalet | 13,258 | 15,717 | 2,459 | 16% |
| Shp. - Iber Lepenci | 137,157 | 139,243 | 2,086 | 1% |
| Shpenzimet tjera | 59,980 | 77,819 | 17,839 | 23% |
| Uji I pafaturuar në m3 | 3,320,241 | 3,292,637 | (27,604) | -1% |
| Uji I pafaturuar ne % | 50.5% | 48.0% | | -3% |
| Mbulimi operativ | 102% | 122% | | 20% |

*Tabela 16. Krahasimi TM2-2025 me TM2-2024 KRUM – Mitrovica sh.a Total*

| TREGUESIT | TM2-2024 | TM2-2025 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi m3 | 6,991,572 | 6,861,623 | (129,949) | -2% |
| Faturimi m3 | 3,142,210 | 3,568,986 | 426,775 | 12% |
| Faturimi nga uji € | 1,239,619 | 1,524,366 | 284,747 | 19% |
| Faturimi- te tjera € | 6,237 | 7,440 | 1,203 | 16% |
| Faturimi Total pa TVSH€ | 1,245,856 | 1,531,805 | 285,949 | 19% |
| Faturimi total me TVSH | 1,350,688 | 1,655,094 | 304,406 | 18% |
| Inkasimi nga uji € | 1,096,852 | 1,277,183 | 180,331 | 14% |
| Inkasimi - te tjera € | 9,457 | 6,049 | (3,408) | -56% |
| Inkasimi Total € | 1,106,309 | 1,283,232 | 176,923 | 14% |
| Nr. i Konsumatorëve | 51,129 | 54,634 | 3,505 | 6% |
| % e inkasimit | 82% | 78% | | -4% |
| Shpenzimet | 1,066,014 | 1,051,011 | (15,003) | -1% |
| Pagat | 620,028 | 637,330 | 17,302 | 3% |
| Rryma elektrike | 202,861 | 153,310 | (49,551) | -32% |
| Shpe. e derivateve | 8,626 | 8,200 | (426) | -5% |
| Miremb. Dhe riparimet | 17,166 | 19,392 | 2,226 | 11% |
| Kemikalet | 23,087 | 15,717 | (7,370) | -47% |
| Shp. - Iber Lepenci | 144,229 | 139,243 | (4,986) | -4% |
| Shpenzimet tjera | 50,016 | 77,819 | 27,803 | 36% |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Uji I pafaturuar në m3 | 3,849,362 | 3,292,637 | (556,724) | -17% |
| Uji I pafaturuar ne % | 55% | 48% | | -7% |
| Mbulimi operativ | 104% | 122% | | 18% |

## 3.2 Realizimi i Planit të Biznesit

*Tabela 17. Realizimi i planit të biznesit Faturimi m3*

| Faturimi m3 | Prill | Maj | Qershor | TM2-2025 |
|---|---|---|---|---|
| MITROVICE realizimi | 342,443 | 328,507 | 347,645 | 1,018,595 |
| Plani | 318,404 | 320,984 | 327,739 | 967,126 |
| % | 107.55% | 102.34% | 106.07% | 105% |
| VUSHTRRI realizimi | 274,181 | 287,370 | 326,346 | 887,897 |
| Plani | 250,850 | 254,637 | 259,163 | 764,651 |
| % | 109.30% | 112.85% | 125.92% | 116% |
| SKENDERAJ realizimi | 83,709 | 83,295 | 86,603 | 253,606 |
| Plani | 90,811 | 94,597 | 96,751 | 282,160 |
| % | 92.18% | 88.05% | 89.51% | 90% |
| M.Veriore realizimi | 468,502 | 459,006 | 481,379 | 1,408,887 |
| Plani | 400,000 | 400,000 | 400,000 | 1,200,000 |
| % | 117.13% | 114.75% | 120.34% | 117% |
| Faturimi ne m3 KRUM realizimi | 1,168,834 | 1,158,178 | 1,241,974 | 3,568,986 |
| Plani | 1,060,065 | 1,070,218 | 1,083,653 | 3,213,936 |
| % | 110.26% | 108.22% | 114.61% | 111.05% |

*Tabela 18.Realizimi i planit të biznesit Faturimi në Euro.*

| Faturimi euro | Prill | Maj | Qershor | TM2-2025 |
|---|---|---|---|---|
| MITROVICE realizimi | 208,500 | 202,703 | 216,741 | 627,944 |
| Plani | 189,454 | 191,042 | 195,624 | 576,120 |
| % | 110.05% | 106.10% | 110.79% | 109% |
| VUSHTRRI realizimi | 152,000 | 161,076 | 177,113 | 490,189 |
| Plani | 138,763 | 141,084 | 143,481 | 423,328 |
| % | 109.54% | 114.17% | 123.44% | 116% |
| SKENDERAJ realizimi | 55,900 | 55,421 | 55,377 | 166,698 |
| Plani | 55,651 | 57,706 | 58,882 | 172,239 |
| % | 100.45% | 96.04% | 94.05% | 97% |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| M.Veriore realizimi | 79,653 | 78,039 | 81,842 | 239,535 |
| Plani | 73,440 | 73,440 | 73,440 | 220,320 |
| % | 108.46% | 106.26% | 111.44% | 109% |
| Faturimi ne euro KRUM realizimi | 496,054 | 497,239 | 531,073 | 1,524,366 |
| Plani | 457,308 | 463,272 | 471,427 | 1,392,007 |
| % | 108.47% | 107.33% | 112.65% | 109.51% |

*Tabela 19.Realizimi i planit të biznesit Inkasimi*

| Inkasimi nga uji | Prill | Maj | Qershor | TM2-2025 |
|---|---|---|---|---|
| MITROVICE realizimi | 228,142 | 195,513 | 187,102 | 610,758 |
| Plani | 199,239 | 200,733 | 205,126 | 605,098 |
| % | 114.51% | 97.40% | 91.21% | 101% |
| VUSHTRRI realizimi | 154,629 | 164,330 | 162,631 | 481,589 |
| Plani | 144,882 | 147,064 | 149,244 | 441,190 |
| % | 106.73% | 111.74% | 108.97% | 109% |
| SKENDERAJ realizimi | 56,416 | 67,172 | 61,249 | 184,836 |
| Plani | 59,316 | 61,208 | 62,300 | 182,824 |
| % | 95.11% | 109.74% | 98.31% | 101% |
| Inkasimi KRUM realizimi | 439,187 | 427,014 | 410,982 | 1,277,183 |
| Plani | 403,437 | 409,005 | 416,670 | 1,229,112 |
| % | 108.86% | 104.40% | 98.63% | 103.91% |

# 4. SHËRBIMI KOMERCIAL

## 4.1 Përmbledhje

Gjatë TM2 2025, Shërbimi Komercial ka vazhduar me aktivitetet e rregullta, duke përfshirë inkasimin, faturimin, inspektimin, aktivitetet promovuese dhe veprimtari të tjera në përputhje me përgjegjësitë e këtij departamenti.

Në nivel të KRU-së, kemi shënuar:

- Rritje të inkasimit me **14%** apo 180,330.65 më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar;
- Rritje të faturimit me **19 %**;

Rezultatet e arritura mund të shihen në dy figurat e më poshtme:




***Figura 1. Krahasimi i inkasimit për TM2 2024/2025***

Suksesi i arritur i inkasimit ka ardhur si rezultat i punës në:

- Identifikimin e gjendjes në terren,
- dërgimin e vërejteve konsumatorëve,
- riprogramimi i borgjit për pagesë me këste,
- Shkyçjet nga rrjeti i ujëjellësit,
- Identifikimi i kyçjeve ilegale dhe
- Faturimi i tyre sipas rregulloreve të ARRU-së
- Thirrjet në telefon,
- Aktivitetet me mediat/rrjete sociale,
- Shqiptimi i gjobave dhe efekti i tyre në teren.




*Figura 2. Krahasimi i faturimi për TM2 2024/2025*

Rezultatet e arritur në faturim kanë ardhur si rezultat i aktiviteteve të lexuesve dhe ekipës së kontrollit përmes identifikimit të kyçjeve ilegale dhe vendosja e ujëmatësve, leximi i rregullt i ujëmatësve, ardhja e diasporës në vend etj.

**Tabela 20. Krahasimi i Inkasimit&Faturimit për TM2 2024/TM2 2025**

| | TM2 2024 | | | TM2 2025 | | | Rritja në % e inkasimit 2025/2024 | Rritja ne € |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| NJ.O | Inkasimi | Faturimi | Shk.Inknë % | Inkasimi | Faturimi | Shk.Ink në % | | |
| Mitrovica | 561,134 | 550,326 | 101.96% | 610,758 | 677,976 | 90.09% | 8.84% | 49,624 |
| Vushtrria | 370,258 | 396,792 | 93.31% | 481,589 | 528,452 | 91.13% | 30.06% | 111,331 |
| Skenderaj | 165,461 | 156,324 | 105.84% | 184,836 | 180,083 | 102.64% | 11.71% | 19,376 |
| KRUM | 1,096,853 | 1,103,441 | 99.40% | 1,277,183 | 1,386,511 | 92.11% | 16.44% | 180,331 |

**Tabela 21. Inkasimi & Numri i Konsumatorëve dhe Mesatarja e Inkasimit për Konsumator**

| NJO | TM2 2025 | | |
|---|---|---|---|
| | Inkasimi | Numri konsumatorëve | Inkasimi mesatar/konsumator € |
| Mitrovica | 610,757.64 | 24,248 | 8.40 |
| Vushtrria | 481,589.30 | 20,246 | 7.93 |
| Skenderaj | 184,836.38 | 9,743 | 6.32 |
| KRUM | 1,277,183.32 | 54,237 | 7.85 |

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, mesatarja e të ardhurave të inkasuara për çdo konsumator është si më poshtë:

- **Mitrovica:** 8.40 €
- **Vushtrria:** 7.93 €
- **Skenderaj:** 6.32 €
- **Në nivel të KRU-së:** 7.85 € për konsumator për muaj.

Këto shifra ofrojnë një pasqyrë të qartë të shumës mesatare të inkasimit për konsumatorë në secilin rajon, duke reflektuar performancën financiare të shërbimit në zona të ndryshme.

Në anën tjetër nëse e krahasojmë faturimin mesatar për konsumatorë del se : Mitrovica faturon 9.32m3/konsumatorë; Vushtrria 8.70m3/konsumatorë dhe Skenderaj 6.16m3/konsumator.

Nga kjo shihet se dallimi në mes njësive operative prej gati 2 eurosh në pagesën për konsumatorë vjen si rezultat i faturimit për konsumatorë. Ketu ka pasur ndikim edhe numri kontratave të lidhura për konsumator: Mitrovica për çdo 89 konsumatorë ka një kontratë riprogramimi, Vushtrria për çdo 110 konsumatorë ka një kontratë dhe Skenderaj çdo 304 konsumatorë ka një kontratë.

**Tabela 22. Kontratat e Shërbimit dhe Riprogramimit - Krahasimi**

| NJO | Kontrata –TM2 2024 | | Vlera€ | Kontrata –TM2 2025 | | Vlera € |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Shërbimi** | **Riprogramimi** | **Riprogramuar** | **Shërbimi** | **Riprogramimi** | **Riprogramuar** |
| **Mitrovica** | 483 | 140 | 89,298 | 553 | 177 | 105,531 |
| **Vushtrria** | 156 | 86 | 54,770 | 299 | 144 | 107,361 |
| **Skenderaji** | 88 | 20 | 11,549 | 68 | 26 | 16,278 |
| **KRUM** | 727 | 245 | 155,616 | 920 | 347 | 229,169 |

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, vihet re një rritje e numrit të kontratave të riprogramimit. Vlera e borxhit të riprogramuar është për **73,553 €** më e lartë krahasuar me TM2 te vitit te kaluar. Nga 2,642 konsumatorë me kontrata rrjedhëse (që i faturohen kistet) riprogramimi , 971 konsumatorë nuk e respektojnë kontratën në tërësi, prandaj kërkohet që të bëhet më tepër presion tek konsumatorët për respektimin e kontratave ose në të kundërtën të pasoj shkyçja nga rrjeti i ujësjellësi dhe inicimi i procedurave përmbarimore. Si qelës për gjenerimin e listave të borgjit te papaguar është marrur vlera mbi 100€ e borgjit aktual .

Ndërkohë, numri i kontratave të shërbimit ka shënuar rritje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke reflektuar një angazhim të shtuar në ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Për

102 kontrata ma i madh se numri i kontratave te TM2 te vitit te kaluar Gjatë periudhës TM2 Mitrovica ka bërë 270 kontrata riprogramimi, Vushtrria 201 dhe Skenderaj 32 kontrata riprogramimi.

***Tabela 23. Kontrata riprogramimi për 1000 konsumatorë***

| | | TM2 2025 | |
|---|---|---|---|
| **NJO** | Numri i kontratave të riprogramimit | Nr. I kosnumatoreve | Kontrata të lidhura për 1000 konsumatorë |
| **Mitrovica** | 270 | **24,248** | 11 |
| **Vushtrria** | 201 | **20,246** | 10 |
| **Skenderaj** | 32 | **9,743** | 3 |
| **KRUM** | 503 | **54,634** | 9 |

**Tabela 24. Numri i Pagesave – Krahasimi**

| | TM2 2024 | | | TM2 2025 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| NJO | Numri i Pagesave | Vlera e Pagesave | Pagesa mesatare perkons.pagues | Numri I Pagesave | Vlera e Pagesave | Pagesa mesatare perkons.pagues/muaj |
| Mitrovica | 23,725 | 561,134 | 7.88 | 25,527 | 610,758 | 7.98 |
| Vushtrria | 17,662 | 370,258 | 6.99 | 20,316 | 481,589 | 7.90 |
| Skenderaj | 6,700 | 165,461 | 8.23 | 6,965 | 184,836 | 8.84 |
| KRUM | 48,087 | 1,096,853 | 7.60 | 52,808 | 1,277,183 | 8.06 |

Siq shifet nga paraqitja tabelare kemi rritjen e pagesës mesatare dhe rritjen e numrit të pagesave.

Numri i pagesave është rritur me 4,721 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe vlera e inkasuar ka shënuar një rritje prej 180,330 €, duke reflektuar përmirësim të dukshëm në performancën financiare. Numri I pagesave është shpesh më I lartë sesa numri I konsumatorëve për faktin se ka konsumatorë që bëjnë më shumë se një pagesë gjatë muajit.

Më poshtë paraqiten aktivitetet dhe aksionet e realizuara në terren, të cilat përfshijnë identifikimin e konsumatorëve ilegalë, regjistrimin e konsumatorëve të rinj, si dhe veprime të tjera relevante.

**Tabela 22. Të dhënat e ndryshme**

| TM2 2025 Nj.Operative | Konsumator Ilegal | Paushall - ujëmatës | Ujmates të Përbashkët në Individual | Konsumator të rinj | Ndrrim ujëmatësi | Konsumator të pasivizuar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mitrovicë | 90 | 152 | 7 | 164 | 117 | 26 |
| Vushtrri | 131 | 6 | - | 869 | 96 | 1 |
| Skenderaj | 1 | 12 | - | 172 | 84 | 22 |
| Totali: | 222 | 170 | 7 | 1,205 | 297 | 49 |

Aktiviteteve të kontrollit nuk u ka munguar vazhdimësia dhe intensiteti. Që nga fillimi i tremujorit të dytë (TM2), kemi intensifikuar veprimet duke zhvilluar kontrolle më të shpeshta, më të detajuara dhe të fokusuara kryesisht në identifikimin dhe parandalimin e keqpërdorimeve të ujit. Gjatë kësaj periudhe, janë përfshirë zona urbane dhe rurale, me prioritet konsumatorët me dyshime për kyçje ilegale, manipulim të ujëmatësve apo shmangie të detyrimeve kontraktuale. Për çdo rast të evidentuar, janë ndërmarrë masat ligjore dhe administrative të parashikuara, duke u koordinuar ngushtë me njësitë operative përkatëse dhe Zyrën Ligjore të kompanisë.

**Tabela 25. Verifikimet dhe Montimet e Ujëmatësve**

| Njësit Operative | Verifikime | Montime |
|---|---|---|
| Totali | 3,180 | - |

**Tabela 26. Ankesat dhe Kërkesat e Konsumatorëve (CRM)**

| Ankesat/Kerkesat Komerciale | Ankesat Komerciale | Kërkesat Komerciale |
|---|---|---|
| Totali | 60 | 456 |

# 5. SHËRBIMI TEKNIK

## 5.1 Distribuimi

Pavarësisht sfidave të shumta gjatë kësaj periudhe – përfshirë temperaturat e larta, keqpërdorimet dhe gjendjen e amortizuar të rrjetit të furnizimit – gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025 është arritur të përpunohet dhe të shpërndahet një sasi e konsiderueshme e ujit.

Gjatë kësaj periudhe janë shpërndarë gjithsej **6,861,623 m³** ujë, të ndarë si vijon:

- Nga **ITU Shipol**: 4,932,708 m³
- Nga **ITU Balinc**: 1,928,915 m³

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kjo përfaqëson një ulje prej **129,949 m³** në totalin e ujit të distribuar. Megjithatë, kjo rënie nuk ka ndikuar në cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve, e cila është ruajtur në nivel të qëndrueshëm dhe brenda standardeve të kërkuara.

Të dhënat e detajuara janë paraqitur në tabelën më poshtë.

*Tabela 27. Distribuimi i ujit nga ITU*

| Uji i prodhuar-ITU | Shipol m³ | l/s | Balinc m³ | l/s | Totali m³ |
|---|---|---|---|---|---|
| TM1 | 4,830,203 | 621.168 | 1,744,699 | 224.369 | 6,574,902 |
| TM2 | 4,932,708 | 627.379 | 1,928,915 | 245.334 | 6,861,623 |
| **Total** | **9,762,911** | | **3,673,614** | | **13,436,525** |

*Tabela 28. Krahasimi i furnizimit nga ITU 2025 dhe 2024*

| Uji i prodhuar ITU-të | Viti 2025 m³ | Viti 2024 m³ | Diferenca m³ |
|---|---|---|---|
| TM1 | 6,574,902 | 6,765,491 | (190,589) |
| TM2 | 6,861,623 | 6,991,572 | (129,949) |
| Total | 13,436,525 | 13,757,063 | (320,538) |

## 5.2 Kualiteti i ujit

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025, bazuar në raportimet e rregullta të menaxherëve të fabrikave dhe analizat fiziko-kimike të kryera në laboratorët e brendshëm, është konstatuar se cilësia e ujit të trajtuar ka qenë plotësisht në përputhje me standardet e përcaktuara për ujin e pijshëm.

Analizat laboratorike të realizuara në të gjitha njësitë prodhuese kanë treguar rezultate brenda kufijve të lejuar, duke dëshmuar efikasitetin dhe stabilitetin e proceseve të trajtimit.

Këto rezultate janë konfirmuar edhe nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës (IKShPK), dega në Mitrovicë, i cili ka kryer analiza të pavarura mbi mostrat e ujit të papërpunuar dhe të përpunuar. Vlerësimet e tyre janë përputhur plotësisht me ato të laboratorëve tanë, duke garantuar besueshmëri dhe transparencë në raportim.

Përveç kësaj, IKShPK ka verifikuar një numër të konsiderueshëm mostrash në rrjetin e shpërndarjes, të cilat kanë konfirmuar cilësi të lartë të ujit të pijshëm në të gjithë zonën e shërbimit të KRU "Mitrovica".

Gjithashtu, një pjesë e parametrave bazë të cilësisë së ujit monitorohen në mënyrë të vazhdueshme përmes sistemit digjital, 24 orë në ditë, duke mundësuar identifikimin në kohë të çdo devijimi dhe reagim të menjëhershëm, me qëllim ruajtjen e një cilësie të qëndrueshme dhe të sigurt të furnizimit.

### *5.3 Kemikatet*

Gjatë tre mujorit I dhe II, për trajtim të ujit të pa përpunuar është përdorur si koagulant kloruriferrik, ndërsa si dezinfektues klori i gazët në të dy ITU-të..

Tabela 29. Sasia e kemikateve të përdorura TM

| Muaji | Shipol | Balinc | Shipol | Balinc | Shipol | Balinc | Shipol | Balinc |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Alumin sulfati –kg | | Polielektroliti kg | | Klori gaz kg | | Kloruriferrik kg | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| TM1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5,196 | 2,156 | 18,580 | 8,500 |
| TM2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5,417 | 2,476 | 31,290 | 7,410 |
| Total | 0 | 0 | 0 | 0 | **10,613** | **4,632** | **49,870** | **15,910** |
| Gjithesej dy ITU-të | 0 | | 0 | | **15,245** | | **65,780** | |

### *5.4 ITUN në Skenderaj*

**Gjatë tre mujorit**, janë trajtuar **148,758 m³** ujëra të zeza. Gjatë tre mujorit të parë nuk ka pasur probleme teknike. Në laboratorin e impiantit merren 12 mostra dhe janë analizuar 27 parametra, nga secila mostër dhe uji i trajtuar i plotëson kriteret për tu derdhur në lumë.

### *5.5 Raport i Njësive Operative*

Gjatë tre mujorit të tri njësitë operative janë furnizuar me ujë me **5,452,736 m³**, ndërsa për Komunat Veriore, Mitrovica e Veriut, Zveçan,së bashku me fshatin Suhodoll është furnizuar me **1,408,887 m³**, siç shihet në tabelën më poshtë.

***Tabela 30 Furinizimi me ujë sipas njësive operative***

| Qyteti / Periudha | Mitrovica Jugore | Vushtrri | Skenderaj | Mitrovica Veriore | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **TM 1** | 2,859,610 | 1,744,699 | 612,000 | 1,358,393 | 6,574,902 |
| **TM 2** | 2,798,513 | 1,928,915 | 725,308 | 1,408,887 | 6,861,623 |
| **Totali** | 5,658,123 | 3,673,614 | 1,337,508 | 2,767,280 | 13,436,525 |

**Njësite Operative Mitrovicë ,Vushtrri dhe Skenderaj** - gjatë tre mujorit, kanë pranuar 1072 ankesa sic shihet në tabelën në vijim, prej të cilave 645 ankesa kanë qenë rrjetit të ujit dhe 427 kanë qenë për mirëmbajtje të rrjetit të kanalizimit. Njësitë Operative, gjatë tre mujorit të parë dhe të dytë, kanë qenë aktive në riparime të rrjetit të ujit, dhe në parandalimin e keqpërdorimit të ujit. Mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit, po arrihet që të përfundohen ankesat e konsumatorëve me sukses.

### *5.6 Sektori i mirëmbajtjes së automjeteve*

Sektori i mirëmbajtjes së automjeteve ka kryer aktivitetet të cilat kanë ndikuar në mënyrë që njesitë operative të jenë në nivel.

*Tabela 31. Parametrat e mirëmbajtjeve të rrjetit të ujit dhe kanalizimit TM2*

| Nr | Njesitë Operative | Njesia | Prill | Maj | Qershor | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Parametrat e rrjetit te ujit | | | | | |
| 2 | Nr.i ankesave | nr | 239 | 225 | 181 | 645 |
| 3 | Nr.i ankesave të realizuara | nr | 238 | 225 | 181 | 644 |
| 4 | Nr.i ankesave të pa realizuara | nr | 1 | 0 | 0 | 1 |
| 5 | Numri i prishjeve në gypat kryesor të ujësjellësit nën Ø63mm | nr | 95 | 105 | 94 | 294 |
| 6 | Numri i prishjeve të riparuara në gypat kryesor të ujësjellësit nën Ø63mm | nr | 95 | 105 | 94 | 294 |
| 7 | Numri i prishjeve në gypat e kyçjes së ujësjellësit mbi Ø63mm | nr | 126 | 76 | 54 | 256 |
| 8 | Numri i prishjeve të riparuara në gypat e kyçjes së ujësjellësit mbi Ø63mm | nr | 126 | 76 | 54 | 256 |
| 9 | Gjatesia e rrjetit të ujësjellësit | M | **1,651,966** | **1,651,966** | **1,651,966** | **1,651,966** |
| 10 | Kyçje të reja në ujësjellës | nr | 19 | 28 | 35 | 82 |
| 11 | Montimi i ujëmatësve | nr | 34 | 32 | 41 | 107 |
| 12 | Riparimi i ujëmatësve | nr | 1 | 2 | 2 | 5 |
| 13 | Gjatësia e gypit të zëvendësuar | M | 278 | 248.5 | 71 | 597.5 |
| | **Rrjeti i kanalizimit** | | | | | |
| 1 | Ankesat | nr | 178 | 134 | 115 | 427 |
| 2 | Ankesat e realizuara | nr | 178 | 134 | 115 | 427 |
| 3 | Ankesat e pa realizuara | nr | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Nr. i përgjithshëm i pusetave të kanalizimit | nr. | **3,980** | **3,980** | **3,980** | **3,980** |
| 5 | Nr. i pusetave të kanalizimit të inspektuara | nr. | 59 | 54 | 63 | 176 |
| 6 | Gjatësia e rrjetit të kanalizimit të pastruar | M | 8,657 | 5,409 | 10,152 | 24,218 |
| 7 | Numri i bllokimeve në kanalizim | nr./cop | 85 | 66 | 94 | 245 |
| 8 | Gjatësia e rrjetit të kanalizimit | M | **282,201** | **282,201** | **282,201** | **282,201** |
| 9 | Kyçje të reja në kanalizim | nr./cope | 7 | 12 | 0 | 19 |
| | | | | | | |

## 5.6 Planifikimit & Zhvillimit

*Tabela 32. Të dhënat e inkorporuara në GIS*

| Përshkrimi | 01.04.2025-30.06.025 |
|---|---|
| Nr.i konsumatorëve në sistemin e faturimit | 54,634 |
| Nr.i konsumatorëve në GIS | 51,073 |
| Diferenca mes Faturimit -GIS | 3,561 |
| Nr.i konsumatorëve që kanë nevojë për verifikim-GIS | 59 |
| Konsumatorët : | 93.48% |
| Nr. I burimeve të ujit /marrjes -GIS | 1 |
| Rrjeti primar dhe sekondar | 89.1% |
| Nr. i FPU-GIS | 3 |
| Nr.Rezervuarëve -GIS | 59 |
| Nr.Stacioneve të Pompimit -GIS | 35 |
| Nr. i valvuleve operuse -GIS | 804-të hapura<br>15-të mbyllura |
| Nr. i valvuleve të ajrimit -GIS | 48 |
| Nr. i valvulave të redukimit të shtypjes -GIS | 14 |
| Nr.ujëmatësave zonal -GIS | 126 |
| Hidrant-GIS | 60 |
| Defektet-GIS | 865 |
| Pompa-GIS | 80 |
| Ujëmatësa në prodhim-GIS | 5 |
| Rrjeti i kanalizimit -GIS | 264.157km |
| Nr.Pusetave te kanalizimit-GIS | 7057 |
| Nr. defekteve -GIS | 1515 |

*Tabela 33. Kërkesat/Ankesat*

| Nr. | Përshkrimi i kërkesave | Viti 2025 | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | IV | V | VI | Totali |
| 1 | Numri i kërkesave te pranuara | 72 | 110 | 73 | 255 |
| 2 | Shqyrtimi i kërkesave | 70 | 107 | 71 | 248 |
| 3 | Kërkesa për Kyçje | 5 | 3 | 1 | 9 |
| 4 | Kërkesa për Ri- Kyçje | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Kërkesa për Legalizim | 24 | 61 | 37 | 122 |
| 6 | Kërkesa për ndërtesa shumëkatëshe | 2 | 2 | 3 | 7 |
| 7 | Kërkesa për pëlqime | 13 | 17 | 12 | 42 |
| 8 | Detektimi & hulumtimi i rrjedhjeve në Mitrovicë | 25 | 22 | 22 | 67 |
| 9 | Hulumtimi i rrjedhjeve ne menyrë vizuele | 1 | 2 | 1 | 4 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 10 | **Evidentimi në GIS - kyçje, legalizime dhe pëlqime.** | 70 | 107 | 71 | 248 |

## 5.7 Punimet dhe Zhvillimet për Pjesë Veriore

*Dëshmi për Kapacitete Teknike, Menaxheriale dhe Operative për Mbulesën e Zonës së Re*

Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Mitrovica" Sh.A, në përputhje me zgjerimin e përgjegjësive në komunat veriore, përmes këtij dokumenti deklaron gatishmërinë dhe disponueshmërinë e kapaciteteve teknike, menaxheriale dhe operative për të siguruar mbulimin e plotë të zonës së re të shërbimit.

### 1. Funksionimi Aktual

Aktualisht, kompania ka funksionalizuar strukturën organizative në përputhje me planin operativ të miratuar. Janë hapur konkurse për pozicionet e parashikuara në këtë plan, të cilat do të forcojnë kapacitetin e shërbimit në komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

### 2. Fabrika e Ujit në Zubin Potok

Fabrika e ujit në Zubin Potok operon në bazë të ndërrimeve 24-orëshe, duke përfshirë tre kompani rajonale:

- Dy ndërrime mbahen nga KRU "Mitrovica",
- Një ndërrim nga KRU "Prishtina",
- Një ndërrim nga KRU "Gjakova".

Ekipet operacionale përbëhen nga operatorë teknikë, laborantë përgjegjës për kontrollin e cilësisë së ujit dhe dozatorë për menaxhimin e kimikateve. Menaxheri i fabrikës së Shipolit mbikëqyr operacionet, ndërsa mbështetja teknike sigurohet nga ekipi i elektromakinerisë i KRU "Mitrovica".

Deri më tani, funksionimi ka qenë i qëndrueshëm dhe pa pengesa operative.

### 3. Menaxhimi i Njësive në Veri

Menaxhimi i operacioneve në komunat veriore realizohet në mënyrë të koordinuar nga një koordinator i caktuar për zonën e veriut, në bashkëpunim me shefin e rrjetit dhe ekipet e mirëmbajtjes së rrjetit të ujit. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit për këtë zonë mbulohet nga ekipi teknik që operon nga jugu.

Operacioni i plotë dhe i qëndrueshëm i njësive në komunat veriore pritet të fillojë së shpejti, pasi janë hapur konkurset për të gjitha pozicionet e parashikuara në planin operativ. Pas përfundimit të procesit të rekrutimit, strukturat e reja do të jenë të gatshme të marrin përgjegjësitë përkatëse, duke siguruar kontinuitet dhe efikasitet në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në zonën e re të menaxhimit.

### Përfundim

KRU "Mitrovica" Sh.A konfirmon se disponon kapacitete të plota teknike, menaxheriale dhe njerëzore për ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme dhe cilësore në zonën e re të menaxhimit, në përputhje me standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga ARRU dhe institucionet kompetente.

**Tabela 34. Sasia e ujit e shpërndar nga ITU Zubin Potok**

| Shpërndarja e sasisë së ujit nga ITU Zubin Potok ($m^3$) | Mitrovicë-Veri (një pjesë) | Zveqani | Banov-Zherovnicë | Kruzhnitok |
|---|---|---|---|---|
| Korrik | 266,500 | 65,620 | 9910 | 11,518 |
| **Totali** | **266,500** | **65,620** | **9,910** | **11,518** |

***Tabela 35. Sasia e kemikateve të përdorura***

| | Klori i gazët (kg) | Sulfati i aluminit (kg) |
|---|---|---|
| Korrik | 387.5 | 87 |
| **Totali** | **387.5** | **87** |

***Tabela 36. Intervenimet teknike në rrjetin e ujit***

| Nr | Njësitë Operative | Njësia | Veriu |
|---|---|---|---|
| 1 | **RRJETI I UJËSJELLËSIT** | | |
| 2 | Nr. I ankesave | Nr/copë | 54 |
| 3 | Nr.i ankesave të realizuara | nr./copë | 54 |
| 4 | Nr.i ankesave të pa realizuara | nr./copë | 0 |
| 5 | Numri i prishjeve në gypat kryesor të ujësjellësit nën Ø63mm | nr./copë | 44 |
| 6 | Numri i prishjeve të riparuara në gypat kryesor të ujësjellësit nën Ø63mm | nr./copë | 44 |
| 7 | Numri i prishjeve në gypat e kyçjes së ujësjellësit mbi Ø63mm | nr./copë | 10 |
| 8 | Numri i prishjeve të riparuara në gypat e kyçjes së ujësjellësit mbi Ø63mm | nr./copë | 10 |
| | **RRJETI I KANALIZIMIT** | | |
| 1 | Ankesat | nr | 14 |
| 2 | Ankesat e realizuara | nr | 14 |
| 3 | Numri i bllokimeve në kanalizim | nr./copë | 14 |

## 6. IMPIANTI PËR TRAJTIMIN E UJRAVE TË ZEZA – PROJEKTI

| | |
|---|---|
| **Projekti:** | **ID e Projektit: 50458 "Ndërtimi i Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza- Mitrovicë" - Vushtrri** |
| **Implementues:** | *Kompania Regjionale Ujësjellësi -Mitrovicë* |
| **PA Lokacioni:** | *Mitrovicë, Kosovë* |
| **Datë:** | *TM2 2025* |

### 6.1 Aktivitetet e Përfunduara dhe Statusi Aktual i Projektit për Zhvillimin e Ujërave të Ndotura në Mitrovicë

***Aktivitetet e realizuara:***

Më **04.04.2025** është bërë kredia efektive.

Më **14.04.2025** janë nënshkruar dy (2) marrëveshje shumë të rëndësishme për projektin e ujërave të ndotura në Mitrovicë:

- Marrëveshja për Grant ËBIF në vlerë prej **5,000,000 €**.
- Marrëveshja për FOPIP - Grant ASEKO në vlerë prej **33,750 €**.

Më **15.04.2025** është mbajtur Takimi i 13-të i Progresit – Analiza e Raportit, ku është prezantuar raporti fillestar. Konsulenti ka dhënë informacione të përgjithshme për dorëzimin e raportit fillestar, statusin e studimit dhe rezultatet bazë në lidhje me alternativat e vendndodhjes së ITUZ (Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Zeza).

### 6.2 Statusi aktual

Më **19.05.2025**, konsulenca ka dorëzuar Draft Studimin e Alternativave të Vendndodhjes së Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) – Mitrovicë, i cili është shpërndarë te komunat (Mitrovicë, Vushtrri), Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, stafi teknik dhe Departamenti i Zhvillimit të KRUM.

Më **19.06.2025** është mbajtur takimi teknik online lidhur me vazhdimin e projektit dhe hapat që duhet të ndërmerren.

Në vijim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka kërkuar informata shtesë rreth studimit, të cilat janë dorëzuar, dhe aktualisht jemi në pritje të komenteve të tyre.

Më **23.06.2025**, kemi pranuar konfirmimin zyrtar nga Komuna e Vushtrrisë për Draft Studimin e Alternativave të Vendndodhjes së Impiantit Gjithëpërfshirës të Trajtimit të Ujërave të Zeza (ITUZ), në të cilin Komuna e Vushtrrisë rekomandon të vazhdohet me hapat e mëtejshëm në përputhje me studimin e përfunduar.

Momentalisht jemi në pritje të "NO-së", nga banka për raportin, në mënyrë që të vazhdohet me hapat tjerë, përditësimin e dokumenteve, etj.

## 7. ZYRA PËR INFORMIM RAPORTIM DHE MARDHËNIE ME PUBLIKUN

### 7.1 Zyra për Informim, Raportim dhe Marrëdhënie me Publikun

Gjatë periudhës tremujore prill–qershor 2025, Zyra për Informim, Raportim dhe Marrëdhënie me Publikun ka vijuar me përkushtim dhe profesionalizëm në realizimin e aktiviteteve të saj të përditshme, duke siguruar komunikim të vazhdueshëm, të qartë dhe gjithëpërfshirës me konsumatorët dhe opinionin publik. Qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve ka qenë rritja e transparencës institucionale dhe ofrimi i informimit të drejtë, në kohë dhe të verifikuar mbi zhvillimet brenda dhe jashtë kompanisë.

### *7.2 Aktivitetet kryesore të realizuara gjatë kësaj periudhe përfshijnë:*

- Publikime të rregullta për detyrimet kontraktuale të konsumatorëve ndaj ujësjellësit, me synim rritjen e vetëdijes dhe përmirësimin e performancës së arkëtimit;
- Njoftime të vazhdueshme mbi punimet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, përfshirë ndërhyrjet teknike parandaluese dhe ato emergjente;
- Informime të detajuara për ndërprerjet e furnizimit me ujë të pijshëm si rezultat i punimeve planifikuara apo dëmtimeve të papritura;
- Publikime transparente të konkurseve për vendet e lira të punës, duke garantuar barazi dhe mundësi të njëjta për të gjithë kandidatët;
- Njoftime mbi aktivitetet e ekipeve të kontrollit në terren, përfshirë identifikimin dhe shkyçjen e lidhjeve ilegale;
- Informime për mundësitë e riprogramimit të borxheve dhe opsionet lehtësuese të pagesës për konsumatorët me vështirësi financiare;
- Fushata ndërgjegjësuese mbi përdorimin racional të ujit të pijshëm, veçanërisht gjatë periudhave me konsum të lartë.

Në këtë tremujor janë pasqyruar edhe zhvillimet në komunat veriore të Mitrovicës, ku më 13 maj 2025 KRU "Mitrovica" ka marrë zyrtarisht kompetencat për menaxhimin e sistemit të ujësjellësit. Pas këtij procesi, është intensifikuar informimi i publikut mbi aktivitetet në këto komuna, janë shpallur konkurset për vendet e lira të punës dhe njoftimet të publikuara në shqip dhe sërbisht.

### 7.3 Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Me rastin e shenimit të "*Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit*" kemi organizuar një aktivitet edukativo-argëtues kushtuar rëndësisë së biodiversitetit, i cili përfshiu fëmijët e stafit të KRU

"Mitrovica". Në ambientet e ujësjellësit, janë pritur fëmijët e klasës së tretë nga Shkolla "Nonda Bulka" së bashku me fëmijët e stafit, për një ditë të mbushur me kreativitet, lojëra dhe mësim mbi ruajtjen e biodiversitetit.

Ky aktivitet përfshiu lojëra edukative dhe punë kreative në bashkëpunim me organizatën BONEVET, përfshirë edhe *"Murin e premtimeve mjedisore"*, ku fëmijët shprehën angazhimin e tyre për mbrojtjen e natyrës. Në fund të ditës, çdo fëmijë u përkrah me dhurata simbolike, duke nënvizuar rëndësinë e edukimit të brezave të rinj për kujdesin ndaj mjedisit.

### 7.4 Përmbledhje e Prononcimit në Media të Kryeshefit Ekzekutiv

Gjatë periudhës së fundit, Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Mitrovica" ka qenë aktiv në komunikimin institucional përmes mediave, me qëllim informimin transparent dhe sensibilizimin e opinionit publik në lidhje me zhvillimet kyçe në menaxhimin e ujësjellësve dhe shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Në fokus të komunikimeve ka qenë marrja nën menaxhim e sistemeve të ujësjellësit në komunat veriore të Kosovës — Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq — me prioritet garantimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të barabartë me ujë të pijshëm për të gjithë banorët, pa dallim etnik apo gjeografik, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në këto zona.

### 7.5 Intervista ne RTK

Gjatë intervistës në RTK "Pas Dite" më 1 korrik 2025, Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Mitrovica" theksoi:

- Marrjen në menaxhim të ujësjellësve në komunat veriore: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.
- Prioritetin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të barabartë me ujë të pijshëm për të gjithë banorët.
- Sfida e konsumit të lartë gjatë verës dhe nevoja për përdorim racional të ujit.
- Zbatimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe mundësitë për riprogramimin e borxheve.
- Hapjen e konkurseve për staf të ri, duke përfshirë komunitetin serb.
- Investimet për modernizimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes.
- Thirrjen për bashkëpunim dhe përgjegjshmëri qytetare për sigurimin e shërbimeve cilësore.

intervistës së dhënë në emisionin "Pas Dite" të RTK-së më 1 korrik 2025, Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Mitrovica" theksoi përkushtimin e kompanisë për menaxhimin efikas të sistemeve të ujësjellësit në komunat veriore të Kosovës: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

### 7.6 Video mesazhi i Kryeshefit Ekzekutiv

Për më tepër, në kuadër të zhvillimit të stafit dhe forcimit të kapaciteteve njerzore, Kryeshefi Ekzekutiv ka realizuar një video prononcim të dedikuar ftesës për aplikim në vendet e lira të punës. Ky komunikim është bërë në dy gjuhë — shqip dhe serbisht — duke garantuar transparencë dhe mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët nga zonat e ndryshme të shërbimit.

### 7.7 Video mesazhi i Kryeministrit të Kosovë z. Albin Kurti

KRU "Mitrovica" ka shpërndarë gjerësisht video-mesazhin e Kryeministrit të Kosovës, në të cilin ai inkurajon aplikimin për vendet e lira të punës në këtë kompani. Ky mesazh përforcon mbështetjen institucionale për zhvillimin dhe fuqizimin e stafit të KRU-së, duke theksuar rëndësinë e punësimit të të rinjve dhe integrimit të komuniteteve në proceset e shërbimit publik. Video-mesazhi është publikuar në platformat zyrtare dhe rrjetet sociale, duke synuar të arrijë një audiencë sa më të gjerë dhe të nxisë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në konkurset e hapura.

Kjo qasje aktive dhe gjithëpërfshirëse në komunikim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së besueshmërisë institucionale dhe forcimit të lidhjes me komunitetin, duke kontribuar në përmirësimin e shërbimeve dhe menaxhimin efektiv të burimeve ujore në rajonin e gjerë të veprimit të KRU "Mitrovica".

## 8. PROKURIMI

*Tabela 37. Aktivitetet e Prokurimit*

| Numri rendor i prokurimit | Titulli i aktivitetit të prokurimit | Data e inicimit të aktivitetetit të prokurimit | Data e publikimit të njoftimit për kontratë | Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës | Data e nënshkrimit të kontratës ( ne rast anulimi data e njoftimit për anulim) | Vlera e parashikuar e kontratës | Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj. | Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 |
| KURM-25-982-1-3-6 | Furnizim dhe montim me GPS dhe instalim I aplikacionit | 19.2.2025 | 21.2.2025 | 15.4.2025 | 14.4.2025 | 7,000 | 6,399 | PROFESSIONAL ALARM L.L.C. |
| KURM-25-1908-1-2-1 | Furnizim me rregullator presioni, valvula ajërimi dhe pjesë fazonike | 3.3.2025 | 18.3.2025 | 1.5.2025 | 30.4.2025 | 70,000 | 67,488 | Xërxa Hidro Group SH.P.K. |
| KURM-25-3162-1-3-6 | Furnizim me pajisje për asgjësimin e letrave- Shreder Ri tender II | 26.2.2025 | 17.4.2025 | 20.5.2025 | 19.5.2025. | 1,500 | 1,250 | MEDIATECH & PRINT SH.P.K. |
| KURM-25-2732-1-2-1 | Furnizim me Klorur Ferrik | 27.3.2025 | 4.4.2025 | 27.5.2025 | 26.5.2025 | 45,000 | 40,828 | N.T.SH." BIZUN " |
| KURM-25-3077-2-2-1 | Sherbime per mirembajtjen e automjeteve te KUR"Mitrovica"Sh.A Ri tender II | 17.4.2025 | 16.4.2025 | 30.5.2025 | 29.5.2025 | 25,000 | 24,009 | Erdogan Pirqi B.I. |
| KURM-25-3377-1-2-1 | Furnizim me derivate të naftës për automjetet e KUR"Mitrovica" Sh.A | 22.4.2025. | 24.4.2025 | 11.6.2025 | 10.6.2025 | 35,000 | 2,610 | Petrol Company - SH.P.K. |
| KURM-25-4662-1-3-6 | Furnizimi dhe montimi i sistemit te sigurimit nëpër stacione të pompimit dhe rezervuar (vendosja e rrethojave per keto objekte) | 23.5.2025. | 28.5.2025 | 12.6.2025 | 11.6.2025 | 9,900 | 7,766 | MEGRANT ING SH.P.K. |
| KURM-25-2963-1-3-6 | Furnizim me PC, Laptop dhe Monitora | 10.4.2025. | 11.4.2025. | 27.6.2025 | 26.6.2025 | 6,000 | 4,937 | Pattern SH.P.K. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **KURM-25-3523-1-3-6** | Furnizim me rroba të punës për punëtoret e mirembajtjes | 25.4.2025 | 30.4.2025 | 30.6.2025 | 27.6.2025 | 6,000 | 4,779 | Agron Commerce SH.P.K. |

Koment: Me lartë janë të paraqitura vetëm kontratat e nënshkruara, në proces tenderues gjatë këtij tre-mujori janë edhe 7 aktivitete të tjera.